c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	



Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

1. Shtrat Pacienti me mbajtese anesore

Plaftorma dhe konturet e shtratit të pacientit të jenë me material çeliku të paoksidueshëm me veshje epokside, antikoroide. Të mundësojë lëvizjen e prapme si dhe lëvizjen e këmbëve me kontroll nga leva në fund të këmbëve (2 funksione të rregullueshme nga leva manuale). Të ketë 2 (dy) njësi binarë anësor prej alumini. Të ketë 'borde' të kokës dhe këmbëve të çmontueshme me material ABS. Këmbët e kokës dhe këmbët e shtratit të jenë të shkëputshme. Shasia e metalit të jetë poliesteri e ngjyrosur elektrostatisht dhe i mbuluar me ABS plastike. Të ketë 4 (katër) vende për stativ serumit të tipit IV në 4 (katër) qoshet e shtratit të pacientit si dhe të jetë i pajisur me stativ. Të ketë 4 (katër) rrota të rrotullueshme 360 ° ku të paktën 2 (dy) prej tyre të jenë me mekanizëm frenimi. Të mund të dizinfektohet me lehtësi. Të ketë gjatësi të plotë me përmasa afërsisht nga 210 deri në 220 cm si dhe gjerësi të plotë me përmasa afërsisht 100 cm ose më mirë për një mbulim dhe suport komod mbi pacientin. Të shoqërohet me dyshek të zipuar i cili të aplikohet në shtratin aktual me gjerësi afërsisht në rangjet nga 80 deri në 90 cm si dhe të jetë me material rezistent të papërshkrueshëm nga uji. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si tryezë shtrati, broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

2. Krevat vizite

Të ketë strukturë metalike të tipit çelik-inoks. Shtrati i vizitave të jetë me gjatësi afërsisht në rangjet nga 180 deri në 195 cm, gjerësi afërsisht në rangjet nga 60 deri në 70 cm dhe lartësi afërsisht në rangjet nga 70 deri në 75 cm për të mundësuar pozicionim komod referuar pacientit. Dysheku të jetë i ndarë në dy pjesë: pjesa e kokës (shpinores) e cila të mund të pozicionohet në disa pozicione, si dhe pjesa e trupit. Të jetë e pajisur me dyshek të butë e të rehatshëm, me mbulesë fleksible, material rezistent kundra zjarrit, të jetë antibakterial dhe lehtësisht i dizinfektueshëm si dhe rezistent ndaj ujit. Trashësia e dyshekut të jetë afërsisht 5 cm ose më mirë. Pjesa fikse e trupit dhe këmbëve të ketë dimensione rreth 130 cm ose më mirë dhe gjerësi rreth 60cm ose më mirë. Në pjesën e poshtme të çdo këmbë të ketë mbështetëse plastike kundër rrëshqitjes e cila bën kontaktin me tokën. Mekanizmi

ngritës i pjesës së sipërme (kokës) së dyshekut të jetë në përputhje me dimensionet e shtratit. Shtrati i vizitave të mund të dizinfektohet me lehtësi. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si mbajtëse letre, broshura, manuale etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

3. Komodine bifrontale

Komodina të ketë në strukturë e saj, sirtar, derë, tavolinë e cila zgjatet mbi shtratin e pacientit. Tavolina të jetë e rrotullueshme, e zgjatshme për një aplikim sa më komod mbi pacientin, me lartësi të rregullueshme. Sirtari të jetë i rrëshqitshëm. Struktura të jetë material druri. Pjesa e sipërme të jetë material ABS. Të jetë e pajisur me 4 (katër) rrota me rrotullim 360° nga ku të paktën 2 (dy) prej të cilave të jenë me mekanizëm frenimi. Të mund të dizinfektohet me lehtësi. Të shoqërohet me të gjithë materialet e nevojshme, broshura, manuale etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

4. Shtrat lindje

Shtrati i lindjes të aplikohet në procedura obstetrikale. Të jetë e ndarë në tre seksione: shpina, ndënjësja dhe këmbët. Të ketë tre motorë për rregullim elektronik të lartësisë, shpinës dhe pozicioneve Trendelenburg/Reverse Trendelenburg. Të mund të komandohet nga një panel kontrolli dhe/ose telekomandë. Pjesa e këmbëve të jetë lehtësisht e çmontueshme. Të shoqërohet me dyshek me tre seksione, me materiale antimikrobiale, të jetë rezistent ndaj ujit dhe zjarrit dhe të mund të dizinfektohet me lehtësi. Bazamenti, platforma e dyshekut të jenë prej materiali ABS. Shina anësore të jenë të çmontueshme me material prej celiku inoks / ekuivalent. Të ketë mekanizma të inkorporuar për montimin dhe pozicionimin e aksesoreve në shtrat. Pjesa e shtrirjes (dysheku) të jetë i mbushur me shkume-gome për të ndjekur formën anatomike të trupit. Të ketë amortizatorë goditjesh përgjatë levizjeve. Lartësia e shtratit të jetë e rregullueshme adërsisht në rangjet nga 60 deri në 90 cm ose më mirë. Sipërfaqja e shtratit të jetë me gjatësi jo më pak se 190 cm dhe gjerësia jo më pak se 80 cm. Seksioni i shpinës të jetë i rregullueshëm përafërsisht në vlerat nga 0 deri në 70°. Të suportohen lëvizjet Trendelenburg dhe Reverse Trendelenburg të rregullueshme përafërsisht deri në +/- 15 deg. Të suportojë kapacitetin mbajtës të pacienti të paktën mbi 200 kg. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si: 1 (një) çift mbajtëse këmbësh me veshje materiali të gomuar, me lidhese për fiksime të këmbëve si dhe të jenë me dhe lartësi të rregullueshme, 1 (një) çift mbajtëse anësore të pacientit, 1 (një) njësi bacinelë inoksi me fiksuesin përkatës, Broshura, manuale etj. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

5. Shtrat ekzaminimi Gjinekologjik

Të jetë me material celiku i paoksidueshëm. Shtrati i ekzaminimit gjinekologjik të jetë me 3 (tre) ndarje. Mbështetësja e kokës dhe këmbëve të jenë të rregullueshme për pozicionim komod lidhur me pacientin. Permasat të jenë afërsisht 60x180x80cm ose më mire. Të jetë e mbuluar me lekure sintetike në pjesën e jashtme. Të dizinfektohet me lehtësi. Të jetë rezistente ndaj faktorit të jashtëm si psh uji. Strukturatë jetë metalike në të katër këmbët. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si mbajtëse të këmbëve, stativ IV, bacinelë, broshura, manuale etj. Të suportojë kapacitetin mbajtës të pacientit me peshë afërsisht 200 kg ose më mire. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

6. Krevat neonati

Të jetë me material plastik transparent si dhe të ketë strukturë çeliku të paoksidueshëm. Të mund të dizinfektohet me lehtësi. Të ketë 4 (katër) rrota të rrotullueshme 360° me mekanizëm frenimi. Të jetë i pajisur me dyshek antibakterial të hollë e të rehatshëm për neonatët si dhe të jetë me mbrojtëse kundër faktorëve të jashtëm si uji etj. Të suportojë mekanizmin e lëvizjeve Trendelenburg dhe Reverse Trendelenburg. Të ketë dollap me derë ose dyer në pjesën e poshtme. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

7. Radiant ose (Radiant (sistem ngrohës) dhe reanimimi për neonate)

Të jetë e pajisur me rezistencë ngrohëse me kapacitetet afërsisht në 0-500W ose më mirë. Të suportojë modalitetet e funksionimit si manuale dhe automatike (modaliteti servo). Të ketë ekran për afishimin e temperaturës dhe parametrave të tjerë për monitorimin e gjendjes dhe ecurisë së pacientit. Të afishojë apgar - timer (kronometër). Të ketë sistem të pajisur me një portë për sensor temperature me vendosje sipërfaqësore (në lekure). Të ketë mundësi manuale dhe automatike të kontrollit të temperaturës ose nëpërmjet sensorit të temperaturës. Në modalitetin manual intensiteti i energjisë ngrohëse duhet të rregullohet manualisht nga operatori në të paktën 20 nivele energjie nga

0-100% (ose më mirë). Në modalitetin automatik (servo), të mund të kontrollohet energjia ngrohëse në mënyrë automatike sipas temperaturës së dëshiruar për pacientin dhe sipas informacionit të marrë nga sensori i temperaturës. Intervali i rregullimit të temperaturës të jetë afërsisht 30÷38°C me rezolucion 0.1°C. Monitorim i temperaturës së pacientit të jetë afërsisht në intervalin: 30°C÷42°C me saktësi ±0.1°C. Të jetë i pajisur me llambë ndriçimi për përdoruesin. Dimensionet e përafërta të platformës së pacientit të jenë afërsisht 45 x 65cm ose më mirë. Platforma duhet të mundësojë vendosjen e kasetave 'X-ray' duke mos lëvizur pacientin. Platforma e pacientit duhet të mundësojë pozicionim horizontal në këndet afërsisht 0° ±15°. Të ofrojë mundësi rrotullimi të kokës së radiantit me rreth ±90° për të mundësuar vendosjen e pajisjeve të tjera (njësi portative x-ray, njësi fototerapie, etj.) Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si: 1 (një) njësi sondë temperature multifunksionale. 10 (dhjetë) njësi qarqe neonate duke përfshirë maska për njësinë e reanimimit. 1 (një) njësi stativ të tipit IV për montim në pjesën anësore të pajisjes. 1 (një) njësi 'pole' për montim shiringa infuzioni, përzjerës gazesh, etj. 1 (një) platformë me montim lateral për vendosjen e monitorit të pacientit apo njësisë së reanimimit. Njësia e reanimimit të jetë plotësisht pneumatike pa kërkuar energji elektrike. Të ketë sistem monitorimi dhe kontrolli për presionin e inspirimit PIP. Të suportohet vlera maksimale përafërsisht 50cmH₂O ose më mirë. Të jetë e pajisur me rregullator për vlerën e PEEP. Intervali i presionit të aplikuar të jetë afërsisht 0÷80 cmH₂O ose më mirë. Fluksi i Inspirimit të jetë afërsisht 0÷15 Litra/minutë ose më mirë. Të jetë e pajisur me funksion përzjerës të AIR/O₂. Rregullim i përqindjes së O₂ të jetë afërsisht në nivelin: 20-100% ±5% ose më mirë. Të jetë i pajisur me 2 (dy) dollapë / sirtarë në bazë për mbajtjen e instrumentave / medikamentave mjekësor etj. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024

8. Incubator

Inkubator spitalor për të sapolindur dhe të lindurit prematurë. Të jetë e pajisur me sistem kontrolli me mikroprocesor për monitorim të saktë të temperaturës brenda inkubatorit me vetëtestim. Të mund të kontrollojë dhe monitorojë në mënyrë automatike gjatë gjithë kohës temperaturën e ajrit dhe të lëkurës, përqendrimin e oksigjenit dhe të lagështisë relative. Të ketë panel kontrolli të pajisur me ekran LCD / LED me ngjyra, për të vizualizuar parametrat e kontrollit dhe për të lejuar vlerësimin e gjendjes operacionale të inkubatorit si dhe të paraqesë të dhëna si temperatura e lëkurës, temperatura e ambientit etj. Të ketë peshore të integruar. Të ketë mekanizëm alarmi vizual dhe akustik. Kapaku të jetë i tipit transparent dopio. Struktura të jetë e përbërë nga të paktën 2 (dy) porta hyrëse ose më mirë, 4 (katër) porta manipulimi ose më mirë, 8 (tetë) porta për kalimin e sensorëve ose më mirë tuba ushqimi, etj. Të jetë e pajisur me mbajtëse për kasete të rrezeve X. Të ketë funksion automatik të kompensimit të temperaturës në momentin kur hapet një nga portat hyrëse të inkubatorit duke krijuar një shtresë mbrojtëse ajri. Të mund të dizinfektohet me lehtësi. Sistemi të ketë 4 (katër) rrota me rrotullim 360° o ku të paktën 2 (dy) prej të cilave duhet të jenë me mekanizëm frenimi. Të mundësojë mënyrat e kontrollit si 'servo air' dhe 'servo skin'. Diapazoni të mund të suportohet afërsisht në rangjet nga 20°C deri në 37°C ose më mirë. Kontrolli i lëkurës (Servo control) të përfshijë rangjet afërsisht nga 35 deri në 37°C. Kontrolli i lagështisë të mundësohet afërsisht në rangjet nga 50 deri në 90% ose më mirë. Kontrolli i oksigjenit të mundësohet afërsisht në rangjet 25 -70% ose më mirë. Niveli i zhurmës brenda inkubatorit të jetë më pak se 60dB ose më mirë. Të shoqërohet me një strukturë për montimin e monitorëve, pajisjeve dhe aksesorëve sipas kërkesave të mjekut. Të jetë i pajisur me një set sensoresh për temperaturën e lëkurës, filtra oksigjeni dhe ajri. Të furnizohet sëbashku me një kapë me konektor oksigjeni për neonatë dhe bebe premature. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

9. Llambë e operatorit dhe levizshme e madhe

Të jetë tavanore me dy satelite. Krahu të jetë i rregullueshëm nga lartësia (vetë-mbajtës në çdo pozicion). Trupi i ndriçuesit të jetë i dizenuar për pozicionim të shpejtë dhe komod sipas kërkesave të mjekut në sallën operative. Të mundësojë ndriçim pa krijuar hije përgjatë aplikimit. Të mund të kontrollohet nëpërmjet panelit të kontrollit të tipit LCD / ekuivalent. Llamba mund të rrotullohet në të gjitha nyjet. Të ketë doreza për pozicionimin e llampës nga ana e mjekut. Intensiteti i ndriçimit në 1 m të jetë afërsisht 150.000 Lux ose më mirë. Temperatura e ngjyrave të jetë afërsisht në rangun nga 3500 K deri në 5000 K ose më mirë. Jetëgjatesia e LED të jetë të paktën 50.000 orë pune ose më mirë. Diametri i trupit të llambës të jetë afërsisht 65 cm ose më mirë. Të ketë numër LED të paktën

50 ose më mire. Të jetë lehtësisht e dizinfektueshme. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

10. Lampa salle operatore e levizshme te vogel (Mikrokirurgji, Salla e ORL)

Lampa të jetë e tipit LED. Të mund të transportohet me lehtësi sipas kërkesave të mjekut në ambientet spitalore, kirurgjikale etj. Të shoqërohet me 'trolley' me 4 (katër) rrota me rrotullim 360° ku të paktën 2 (dy) prej tyre të jenë me mekanizëm frenimi. Të mundësojë ndriçim në 1 m në kapacitete afërsisht 100.000 ose më mire. Jetëgjatësia e LED-it të paktën 50,000 orë ose më mire. Temperatura e ngjyrës të jetë afërsisht 4500 K ose më mire. Diametri i satelitit të jetë afërsisht 45 cm ose më mire. Të jetë me intesitet të rregullueshëm sipas kërkesave të mjekut. Të ketë artikulime për levizje lartë/poshtë dhe majtas/djathtas referuar pozicionimit përgjatë aplikimit. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

11. Nebulizator (aerosol)

Nebulizatori të jetë profesional për terapinë aerosol në mjediset spitalore. Të ketë nivel presioni afërsisht 350 kPa ose më mirë. Niveli i zhurmës të jetë për afërsisht 60 dBA ose më mirë. Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm si: maskë adulte dhe pediatrike, maska e hundës, maska e gojës me valvul. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm si: broshura, manuale përdorimi, manuale teknik etj. Të jetë model i fundit dhe prodhim i viteve të fundit 2023 (2024). **Shënim** : Specifikimet teknike u hartuan duke u bazuar në 'research' online në procedura të ngjajshme në lidhje me aparatit e anestezisë kryesisht 'worldwide' si dhe duke studiuar disa modele 'online' referuar karakteristikave të tyre të përbashkëta.

12. Fotometer/ Minitekno

Të mundësojë matje fotometrike si kolorimetri, turbimetri, teste UV, Të mundësojë lexim mono dhe bi-kromatik. Të suportojë diapazonin spektral për afërsisht në rangun 320nm-750nm ose më mire. Të ketë të instaluar të paktën 8 (tetë) filtra me gjatësi vale në rangjet nga 340 deri në 750 nm ose më mirë. Të ketë printer termik të integruar. Lampa (njësia ndriçuese) të mund të ndërrohet nga përdoruesi. Pajisja të mund të lidhet në rrjetin kompjuterik spitalor për komunikimin e të dhënave. Të ketë memorie për ruajtjen e të paktën 7000 rezultateve laboratorike ose më mire. Të suportojë llojin e mostrës si serum, plazmë, urinë, gjak komplet. Pajisja të mund të detektojë flluskat. Të ofrojë mundësi matje me flow, kyveta makro dhe gjysmë-mikro. Të shoqërohet me inkubator të integruar me për afërsisht 8 (tetë) pozicione ose më mirë. Temperatura e inkubatorit të jetë e programueshme. Të mundësojë mënyrat e analizimit si pikë fundore, kohë fikse, kinetike, absorbancë etj. Numri i standardeve për test të jetë të paktën 8 (tetë) ose më mirë. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm si: broshura, manuale përdorimi, manuale teknik etj. Të jetë model i fundit dhe prodhim i viteve të fundit 2023 (2024). **Shënim**: Specifikimet teknike u hartuan duke u bazuar në 'research' online, në procedura të ngjashme në lidhje me aparatit e anestezisë kryesisht 'worldwide' si dhe duke studiuar disa modele 'online' referuar karakteristikave të tyre të përbashkëta.

13. Krevat Salle statike operatore

Tavolina përbëhet nga 5 (pesë) segmente duke mundësuar suport për kokën, shpatullat, ndënjësja dhe segment të ndarë për secilen këmbë si secili segment të mund të pozicionohet sipas kërkesave të mjekut. Struktura e shtratit operator të jetë me material çelik-inoks. Shtrati operator të mund të suportojë dhe të aplikohet në procedura të ndryshme kirurgjikale, mikrokirurgjikale sipas kërkesave të mjekut. Të mund të dizinfektohet me lehtësi si dhe të jetë rezistent kundrejt faktorëve të jashtëm si uji etj. Të mund të komandohet si nga telekomanda ashtu dhe nga paneli i komandimit në shtrat. Dysheku të jetë komod dhe i rehatshëm për pacientin. Pjesa e kurrizit dhe lartësia e tavolinës operatore të mund të pozicionohen sipas kërkesave të përdoruesit. Shtrati të jetë i tipit 'radiolucent' për mbrojtje dhe rezistencë ndaj rrezeve X. Të ketë mekanizma për vendosjen e aksesoreve drejt një aksesit të lehtë dhe të shpejtë nga mjeku. Shtrati operator të ketë përmasat për afërsisht 200 cm x 55 cm ose më mirë. Të suportojë lëvizjet Trendelenburg dhe Reverse Trendelenburg të rregullueshme afërsisht në rangjet -30° + 30° ose më mire. Dysheku të ketë trashësi të paktën 6 cm ose më mirë. Në rast të dëmtimit apo problematikave të komponentit elektronik përgjatë pozicionimit të shtratit

operator, të mundësohet pozicionimi me leva (hidraulik) i tij për të vijuar aplikimin kirurgjikal. Pozicionimi i lartësisë të mund të rregullohet të paktën në rangjet 55 cm deri në 1m ose më mire. Të mundësohet përkulje anësore (majtas/djathtas) për pacientin të paktën në rangjet $+15^{\circ}/-15^{\circ}$ ose më mire. Pjesa e këmbëve të jetë e ndarë në 2 (dy) seksione (1 për secilën këmbë). Telekomanda të ketë butona për pozicionimin e seksioneve të shtratit si dhe shtratit të tërësi. Të mund të suportojë ngarkesën afërsisht 200 kg ose më mirë referuar pacientit. Të shoqërohet me të gjithë aksesorët e nevojshëm si: Rripa me gjatësi të rregullueshme për fiksimin e pacientit, Mbështetëse për krahun, suport për shpatullat, mbështetëse anësore, mbështetëse gjuri të rrotullueshme dhe të përkulshme, kapëse për fiksime, mbështetëse e rrotullueshme dhe e përkulshme për kokën, mbështetëse për kyçet, jastëk mbështetës. Të shoqërohet me të gjithë aksesorët e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

14. Krevat statik salle (Mikrokirugji, ORL)

Shtrat operator elektrik për aplikime kirurgjikale në disiplina të ndryshme mjekësore si ORL, oftalmike, maksilofaciale etj. Të jetë me 4 (katër) seksione për të mundësuar suport dhe mbështetje për kokën, shpinën, trupin dhe këmbët e pacientit sipas kërkesave të mjekut. Të mundësojë pozicionimet në mënyrë elektrike për lartësinë, lëvizjet trendelenburg dhe reverse trendelenburg të shtratit, lëvizjet për kokën, shpinën, këmbët për një aplikim sa më komod. Telekomanda ose paneli i komandimit të mundësojë afërsisht 5 (pesë) pozicione të automatizuara. Të shoqërohet me mekanizëm pedalimi për pozicionimin e shtratit. Të ketë dimensionet gjatësi afërsisht në 200 cm ose më mirë, gjerësi afërsisht 75 cm ose më mirë. Të suportojë kapacitetin mbajtës të pacientit afërsisht në 200 kg ose më mirë. Struktura e shtratit operativ duhet të jetë material celiku i paoksidueshëm. Të ketë 4 (katër) rrota me rrotullim 360° ku të paktën 2 (dy) prej tyre të jenë me mekanizëm frenimi. Të mund të dizinfektohet me lehtësi si dhe të jetë rezistent kundrejt faktorëve të jashtëm si uji etj. Të mund të transportohet me lehtësi në ambientet spitalore / kirurgjikale. Lëvizja në lartësi të mundësohet afërsisht në rangjet nga 60 cm deri në 90 cm ose më mire. Seksioni i kokës të mund të pozicionohet në afërsisht -30° deri në $+30^{\circ}$, dimensionet të jenë afërsisht gjatësi 25cm ose më mirë dhe gjerësi 25 cm ose më mirë. Seksioni i shpinës të ketë dimensionet si gjatësi afërsisht 55 cm ose më mirë dhe gjerësi afërsisht 55 cm ose më mirë. Të mund të pozicionohet afërsisht në rangjet nga 0° deri në 80° ose më mirë. Seksioni i këmbëve të ketë dimensionet për afërsisht 50 cm x 60 cm ose më mirë. Seksioni i krahëve të jetë i pozicionueshëm. Të shoqërohet me mekanizëm të energjisë së vazhduar (bateri). Të ketë sistem alarmi akustik referuar anomalive përgjatë aplikimit. Të ketë buton emergjence për ndalim të menjëhershëm në rast emergjencash mjekësore. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të shoqërohet me të gjithë aksesorët e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

15. Aurosteril

Sterilizatori të jetë me qarkullim të ajrit natyral. Të ketë kapacitet jo më pak se 20 (njëzetë) L. Temperatura të mund të rregullohet për afërsisht në rangjet nga 150°C deri në 250°C me hap 1°C . Të ketë kontroll elektronik mbi temperaturën. Të mund të paraqesë të dhëna në ekran në mënyrë digjitale si temperatura. Të ketë alarme akustike dhe vizuale mbi temperaturën e lartë, rënien e temperaturës, dëmtimet e sensorëve, elementëve të nxehjes etj për të njoftuar përdoruesin në rastin e ngjarjeve të padëshiruara. Të ketë mekanizëm mbrojtjeje kundrejt mbinxehjes lidhur me termostatit. Të funksionojë në rrjetin elektrik shqiptar. Të mund të dizinfektohet me lehtësi. Të ketë strukturë rezistente çelik të paoksidueshëm. Të shoqërohet me të gjithë aksesorët e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, informacione teknike etj. Të jetë prodhim i viteve të fundit 2023, 2024.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Sasia
1	Shtrat Pacienti me mbajtese anesore	61
2	Krevat vizite	12
3	Komedine bifrontale	50
4	Shtrat lindje	1
5	Shtrat ekzaminimi Gjinekologjik	1
6	Krevat neonati	2
7	Radiant ose (Radiant (sistem ngrohës) dhe reanimimi për neonate)	1
8	Incubator	1
9	Llamp salle operatore e levizshme e madhe	1
10	Llamp salle operatore e levizshme te vogel (Mikrokirurgji, Salla e ORL	2
11	Nebulizator (aerosol)	1
12	Fotometer/ Minitekno	1
13	Krevat Salle statike operatore	1
14	Krevat statik salle (Mikrokirugji, ORL)	2
15	Aurosteril	1

Afatet e lëvrimit: 60 dite nga lidhja e kontrates

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

-
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës për të cilat ofertuesi konkurron.

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kritereve të mesiperm e ben oferten të vlefshme

2.3.2. Të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinier në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekesore i cili do të kryej furnizim - vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet **diplomës, certifikatës/certifikatave** së trajnimit sipas aparatures që furnizon, **CV-së, kontratës** individuale të punës. Inxhinjeri duhet të figurojë në **listpagesa** në 3 muajt e fundit para datës së hapjes së tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë origjinin e mallit dhe kompaninë prodhuese ose distributorin e autorizuar. Te plotësohet në shtojcën 2, Lista e cmimeve të artikujve ose të paraqesë një deklaratë mbi origjinin e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjinës.).

2.3.4 Ofertuesi duhet të jete i certifikuar me certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësive dhe prodhuesi të jete i certifikuar me ISO 13485:2016 ose ekuivalente. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën perkatese origjinale ose të perkthyer dhe të noterizuar. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë për pajisjen mjekesore objekt prokurimi, **certifikatën CE** ose deklaratën e konformitetit (sipas kategorizimit perkates) për aprovim të standarteve, direktivave në tregun Europian, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë **autodeklaratë** që pajisja e shoqëruar me aksesoret perkates objekt prokurimi të jete të reja, të përdorura dhe prodhim i viteve të fundit (2023-2024).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. (Autorizimi duhet të jete i vlefshëm).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e mallrave ose nga Distributori i Autorizuar nga prodhuesi (distributori duhet të jete i autorizuar për territorin e Shqipërisë) lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit perkates.

2.3.9 Deklarate per permbushjen e afatit te garancise. Garancia jo me e vogel se nje vit ku perfshihet mirembajtja, zevendesimi i aparatures/pajisjes ose i pjeseve te defektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale te cilat do te sigurohen operatori ekonomik fitues me shpenzimet e veta.

2.3.10 Kërkojen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, te përfshihen specifikimet teknike për secilin artikull (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit www.app.gov.al

2.3.11 Operatori do te kryeje furnizimin, instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.

2.3.12 Operatori duhet te trajnoj stafin mjekesor pas instalimit te pajisjeve mjekesore ne kabinetin perkates.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----

Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
